



Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore (QKCSA-ISH)

NJOFTIM PËR MEDIAN

“Cilësia e keqe e kujdesit shëndetësor dëmton dhe kushton shtrenjte”.

Mbi këtë lajtmotiv Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore pas një periudhe gati 1 vjeçare të ngritjes së saj, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë zhvilloi në ambientet e Hotel Tirana Internacional, **Konferenca e Parë me temë:**

“Cilësia e kujdesit shëndetësor në Shqipëri: E sotmja dhe e ardhmja”

Moderatori i saj është Prof. Isuf Kalo, të cilit, Ministria e Shëndetësisë i ka besuar drejtimin e Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit, duke shpresuar që përvojën e tij të pasur profesionale në institucionet ndërkombëtare ta aplikojë me sukses edhe në Shqipëri.

“Jemi mbledhur që të bashkojmë forcat për një cilësi më të mirë të sistemit tonë shëndetësor, çka në fakt do të thotë të bëjmë së bashku ndryshimin” – tha ai në fjalën përshëndetëse të hapjes. Mesazhi i ndryshimit u dha që në formatin jo të zakonshëm të organizimit të konferencës. Ajo filloi punimet pas një intermexo aristokrate me një kuartet të Moxartit. Pas hapjes nga Prof. Kalo ishte Ministri i Shëndetësisë Prof. Maksim Cikuli që përshëndeti të pranishmit në emër të dikasterit që ai drejton. Fill pas tij të pranishmit patën një surprizë. Si rezultat i teknologjisë së Telemedicinës, përfaqësuesi i saj në këtë konferencë, Dr. Shaip Muja Drejtor i Qendrës së Telemedicinës në Prishtinë, i cili është pjesëmarrës me synimin për të prezantuar teknologjinë informative në Kosovë dhe rolin e saj në përmirësimin e cilësisë, edukimin dhe menaxhimin e shërbimeve shëndetësore, u bë e mundur që Ministri i Shëndetësisë së Kosovës të përshëndeste direkt qe nga Prishtina. Fal kësaj lidhje direkte me Kosovën u mundësua që punimet e konferencës të ndiqeshin njëkohësisht nga koleget kosovarë.

Mjekësia gjithmonë ka pasur në principin misionar human të saj veprimtarinë pa kufi. Në këtë konferencë mjekët shqiptarë këtej dhe andej kufirit ishin vëllazërisht bashkë.

Risi tjetër domethënëse e konferencës ishte vënia në themel të programit të saj të multi partnershipit në arritjen e qëllimit të përbashkët, i cili është përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe standardeve të kujdesit shëndetësor. Ai u konkretizua me apelin e Prof. Kalos: **“Cilësi për të gjithë, cilësi nga të gjithë”** si edhe me anë të përfshirjes në programin e referimeve të partnereve të shumtë të interesuar ku: përveç ekipit të Qendrës së Cilësisë, përfaqësuesve të Ministrisë, referuan edhe Drejtoresha e ISKSH. Magjistër në Shkencat Ekonomi Znj. Elvana Hana, Presidenti i Urdhrit të Mjekut Dr. Dine Abazaj, Drejtori ekzekutiv i Fondacionit Mjekësor Shqiptar Hipokrati Prof. Ass. Andrea Gudha, si edhe mjekë, infermierë, Shoqata e të Sëmurëve, Shoqata e Përfaqësive Farmaceutike, të Qendrës së Akreditimit të Universiteteve dhe referime të përfaqësuesve të agjencive dhe programeve shëndetësore të huaja në vendin tonë, si e USAID etj në Shqipëri.



Ndryshe nga çdo herë tjetër e ftuar ishte edhe një e sëmurë, Znj. I. S. Ajo përfaqësoi qytetarët tanë të shumtë që vuajnë sëmundje të ndryshme dhe përballen çdo ditë me problemet e një kujdesi shëndetësor jo cilësor.

Madje Znj. I.S. u ftua në podium përkrah Zv. Ministres së Shëndetësisë Dr. Zamira Sinoimeri për të drejtuar seancën e parë me titull: **“Të sëmuret si partner në qendër të sistemit shëndetësor”**

Ky hap novator dëshmon për emancipimin e shëndetësisë në drejtimin e demokratizimit të brendshëm të saj të afrimit me të sëmuret dhe njohjes nga afër jo vetëm të problemeve shëndetësore por edhe të jetës, të botës së brendshme emocionale dhe të vështirësive sociale jo të pakta që ata përballojnë.

Në diskutimin e saj me titull: Perceptimet, përjetimet dhe dëshirat e mia për cilësinë e kujdesit shëndetësor, e sëmura I. S. si edhe Z. Musa Zeneli, përfaqësues i Shoqatës së të Sëmurve me Talasemi sollën në sallën e konferencës jetën reale dhe kërkesat e drejta të të sëmurve, jashtë akademizimit dhe retorikës mjekësore.

Ata jo vetëm emocionuan por edhe vunë në mendime të pranishmit për mangësitë e deritanishme dhe domosdoshmërinë e mbështetjes së strukturuar të sëmurve në të ardhmen për ti informuar, edukuar dhe aftësuar ata të luajnë rolin e rëndësishëm në ndarjen me ta të barrës së kujdesit shëndetësor me anë të aftësimit të tyre për vet kontroll dhe vet menaxhim të sëmundjeve nga të cilat vuajnë.

Konferenca u zhvillua në tre seanca ku në secilën prej tyre u trajtuan tema të rëndësishme si:

- 1. Pacienti si partner në qendër të sistemit shëndetësor.**
- 2. Udhëzuesi praktik klinik**
- 3. Cilësia e kujdesit shëndetësor**

Rezultatet e kësaj konference priten të kenë impakt mbi disa elemente thelbësorë të Reformës që ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë nëpërmjet një sërë interventesh të programuara në hallka të ndryshme të sistemit të sotëm shëndetësor, ndaj me synimin tek cilësia u ruajt gjithë koherenca e debateve, rezonanca e shfaqjes dhe rrahjes së problemeve të shëndetësisë. Prurjet e kësaj konference do shërbejnë natyrisht si bazë për ecjen më tej të veprimtarisë së Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit e cila ndonëse në një hark kohor relativisht të shkurtër mundi të sjellë në konference produkte, materiale dhe frute të vlefshme të veprimtarisë së saj.

Konkluzionet dhe fjala e mbylljes u mbajtën nga Prof. Kalo si sintezë shkencore dhe e frymës kolegjiale të partnershipit që karakterizoi dukshëm këtë aktivitet të suksesshëm me nota të theksuara novatorizmi duke e bërë të besueshme cilësinë e kësaj qendre të re, të parë të këtij lloji në Shqipëri, edhe me formën dhe mënyrën e funksionimit të kësaj konference.

Tirane, 18 dhjetor 2006

Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore



**QENDRA KOMBËTARE E CILËSISË,
SIGURISË DHE AKREDITIMIT TË
INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
